



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pratatori Received/Delivered	09.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org /Unit	Id Prot Id Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
S. KMSH/OK	5293/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.670/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.670/2022 të datës 27.07.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____ në Komunën e Vushtrrisë, kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 09.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.670/2022 e datës 27.07.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

II. SHFUQIZOHET Shkresa e Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës e datës 12.07.2022

II. OBLIGOHET Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm e APRK-së dhe Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative që ankuesit t'i ngritët koeficienti nga 6.5 në shtatë (7), ndërsa kompensimin retroaktiv për diferencën e koeficientit nga 6.5 në shtatë (7) t'i paguhet nga data 27.06.2022.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), më datë 27.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4344/2022 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të kërkesës së ankuesit të datës 27.06.2022 nga Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së lidhur me harmonizimin e koeficientit të ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.08.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 12.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 4344/2022 të datës 22.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 27.07.2022 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën e ankuesit të datës 27.06.2022 për harmonizimin e koeficientit së bashku refuzimin e datës 12.07.2022 nga Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së; Akt emërimit të ankuesit të datës 28.12.2017 me numër prot:198; Diplomën e ankuesit të datës 26.08.2015 me numër:278; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.08.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.08.2022 dërguar nga institucionin punëdhënës i ankuesit; Akt emërimit të ankuesit të datës 11.03.2015 me numër protokoli:103; Akt emërimit të ankuesit të datës 29.02.2012 me numër protokoli:428; Kontratën e punës së ankuesit të datës 01.02.2010; Kontratën e punës së ankuesit të datës 20.01.2009; Kontratën e punës së ankuesit të datës 22.01.2007; Kontratën e punës së ankuesit të datës 18.04.2006; Kontratën e punës së ankuesit të datës 31.12.2006; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Trajnimit në QAP; Kërkesën e datës 19.02.2015 me numër proptokoli:232 lidhur me ngritjen e koeficientit të ankuesit; Kontratën e punës së ankuesit e datës 01.01.2004; Listën e pagës së ankuesit të muajit korrik 2022; Kërkesën e dërguar përmes e-maili me datë 05.09.2022 nga Këshilli për Menaxheren e Njesisë së Burimeve Njerëzore në APRK; Përgjigjen e datës 05.09.2022 dërguar nga Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në APRK për Këshillin; Akt emërimit të datës 28.12.2017 me numër protokoli:193 të nëpunësit civil B.O; Diplomën e datës 06.05.2008 me numër:323 të nëpunësit civil B.O.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi se ankesa e ankueses *është pjesërisht e bazuar*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas kontratës së punës së datës 01.01.2004 ka gjetur se ankuesi e ka themeluar marrëdhënien e punës në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, ndërsa sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2017 me numër protokoli:198 ankuesi mban pozitën e punës "Zyrtar i Trajnimit/Zdrukhëtari në Qendrën për Aftësim Profesional-Mitrovicë" në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me koeficient 6.5 dhe po ashtu sipas shkresave të lëndës gjegjësisht Diplomës së datës 26.08.2015 me numër:278 është konstatuar se i njëjti me datë 27.11.2014 i ka përfunduar Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe ka marr titullin Bachelor i Industrisë së Drurit. Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit me datë 11.03.2015 dhe numër protokoli:103 i është lëshuar Akt Emërimi për pozitën "Trajner i Zdrukhëtarisë- Qendrën për Aftësim Profesional-Mitrovicë" në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me koeficient 7 të cilin ankuesi e ka nënshkruar me datë 13.03.2015.

Ankuesi me datë 27.06.2022 me kërkesë i është drejtuar Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës për ngritjen e koeficientit me arsyetimin se i njëjti me datë 27.11.2014 i ka përfunduar studimet në programin e përpunimit të drurit dhe ka marrë titullin Bachelor i Industrisë së Drurit dhe po ashtu ankuesi në kërkesën e njëjtë thekson faktin se ankuesi kërkesë për ngritjen e koeficientit ka bërë edhe në vitin 2014 por se nuk është marrë parasysh. Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së me datë 12.07.2022 e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 27.06.2022 për ngritjen e koeficientit me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore.

Në ankesën e parashtruar me datë 27.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesi pretendon se i njëjti nuk është duke u trajtuar në mënyrë të barabartë dhe duke i mbrojtur nga diskriminimi siç përcaktohet me nenin 19 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi pasi që me datë 27.11.2014 i ka përfunduar studimet themelore dhe avancimit profesional të kërkuar për pozitën që mban, ndërsa kërkon që koeficientit të ngritet nga 6.5 në 7 dhe i njëjti të paguhet në mënyrë retroaktive nga data e 27.11.2014 prej kur ka diplomuar për diferencën e koeficientit 7.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit për ngritjen e koeficienti nga 6.5 në 7, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil neni 3 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...*", si dhe nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*", dhe po ashtu përfaqësuesi i Këshillit me datë 05.09.2022 i është drejtuar Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me kërkesën për sqarime shtesë nëse ka të punësuar në kuadër të Qendrave për Aftësim Profesional-APRK-së që e kanë pozitën e njëjtë sikurse ankuesi dhe paguhen sipas koeficientit 7, ndërsa në përgjigjen e pranuar me datë 05.09.2022 nga Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të APRK-së, është konstatuar se, *citoj: "Përveç ankuesit në APRK ka edhe zyrtarë të tjerë të cilët kanë pozita ekuivalente me ankuesin, diplomë universitare të fushës dhe paguhen me koeficient gjashtë pikë pesë (6.5), pra në AKRP nuk është vetëm ankuesi Gjithashtu ju njoftoj se në AKRP ka edhe zyrtarë me pozitë ekuivalente me të ankuesit por nuk e kanë kualifikimin e universitar të fushës së kërkuar apo janë me kualifikim të mesëm dhe paguhen me koeficient gjashtë pikë pesë (6.5)"* dhe po ashtu e njëjta ka bashkangjitur edhe një akt emërim të datës 28.12.2017 për pozitën e punës "Zyrtar i trajnimit" në Qendrën për Aftësim Profesional në kuadër të APRK-së, pozitë kjo ekuivalente apo e njëjtë me pozitën të cilën e mban ankuesi dhe paguhet me koeficient 7, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor apo kërkesa e ankuesit për ngritjen e koeficientit nga gjashtë pikë pesë (6.5) në shtatë (7) është e bazuar pasi që për të njëjtën pozitë në të njëjtën vend të punës dhe në kuadër të të njëjtit institucionin siç është e specifikuar me kodin MSP800, pozita e punës Zyrtar i Trajnimit në Qendrat për Aftësim Profesional me kërkesën e përcaktuara të kriterëve DU+2 (Diplomë Universitare dhe 2 vite përvojë pune), grada e vendit të punës 9, në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës i cili është miratuar me Vendimin numër 05/12 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 05.02.2015, nuk mund të paguhet ndryshe apo më pak se që përcaktohet me rregullat dhe parimet e përcaktuara të ligjit material dhe ligjit të pagave, pasi që bie ndesh edhe me parimet e përgjithshme të përcaktuara me

nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativoteknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paaanisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”*.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për pagesën në mënyrë retroaktive prej kur i njëjti e ka plotësuar kushtin respektivisht përfundimit të studimeve universitare dhe është diplomuar me datë 27.11.2014, në bazë të shkresave të lëndës të përcjella nga institucioni punëdhënës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi në vazhdimësi është paguar sipas koeficientit gjashtë pikë pesë (6.5), mirëpo është gjetur se ankuesit institucionin punëdhënës me datë 11.03.2015 ia kishte lëshuar ankuesit Akt emërimin me numër protokolli:103 me koeficient shtatë (7), akt emërim të cilin ankuesi e ka pranuar dhe nënshkruar me datë 13.03.2015, mirëpo me datë 28.12.2017 institucionin punëdhënës ankuesit i ka lëshuar akt emërimin me numër protokolli:198 me koeficient gjashtë pikë pesë (6.5) të cilin ankuesi e ka pranuar dhe nënshkruar me datë 17.01.2018, mirëpo ankuesi nuk ka arritur ta dëshmojë me asnjë provë se pavarësisht që me datë 13.03.2015 i është lëshuar Akt Emërimi me numër protokolli:103 me koeficient shtatë (7) dhe është paguar sipas koeficientit gjashtë pikë (6.5) dhe po ashtu edhe kur i është ndryshuar Akt Emërimi me datë 17.01.2018 të ketë parashtruar apo ta ketë parashtruar të drejtën në mjetet ankimore siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjit material, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive nga data 27.11.2014 nuk mund të aprovohet pasi që ankuesi i ka humbur të gjitha afatet e përcaktuara në procedurë administrative, mirëpo pretendimi ankimor i ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive aprovohet vetëm prej datës kur i njëjti ka parashtruar kërkesë për ngritje të koeficientit me datë 27.06.2022 në institucionin punëdhënës.

Andaj, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ankesën e ankuesit të datës 27.07.2022 të parashtruar në Këshill e ka aprovuar pjesërisht duke ia njohur të drejtën për trajtim të barabartë siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publikë lidhur me mos diskriminimin dhe trajtimin e barabartë për pagën sipas koeficientit shtatë (7) njëherit shkresën e datës 12.07.2022 për refuzimin e kërkesës së ankuesit nga Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshme të APRK-së e ka shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi pasi që e njëjta shkresë është e kundërligjshme siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, ndërsa nuk ia ka njohur të plotë kërkesën për pagesë retroaktive nga datat 27.11.2014 pasi që i njëjti i ka humb afatet ankimore të përcaktuara me dispozitat e lartcekura në fuqi, mirëpo e drejta në kompensim retroaktiv i është njohur vetëm nga datat 27.06.2022 kur ankuesi ka dëshmuar se ka parashtruar kërkesë brenda institucionit, kërkesë e cila është refuzuar nga Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së me datë 12.07.2022 kundër së cilit akt ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshill siç përcaktohet me 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë.

Kolegji thekson faktin se Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë të obliguar që të ndër marrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative që ankuesit Ferki Namani t'ia bëjë plotësim ndryshimin e aktit të emërimin



sa i përket koeficientit të pagës dhe i njëjti nga gjashtë pikë pesë (6.5) t'i bëhet shtatë (7), ndërsa kompensimin në mënyrë retroaktive t'ia bëjë vetëm për periudhën kohore nga data 27.06.2022 për diferencën e koeficientit nga gjashtë pikë pesë (6.5) në shtatë (7).


Andaj, pas pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.670/2022

Flakron GASHI


Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

